




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datën 18 gusht 2015, merr këtë

**V E N D I M**

**I.**

1. Çmimi i pagesës mujore për çerdhen me bazë në komunitet "Ngjyrat" do të jetë 100 Euro.
2. Përjashtimisht nga paragrafi i mësipërm, Komuna e Prishtinës do të subvencionojë vetëm prindërit me të ardhura mujore si në vijim:
  - Prindërit me të ardhura mujore deri në 500 Euro, me 50 Euro;
  - Prindërit me të ardhura mujore deri në 700 euro, me 30 Euro; dhe
  - Prindërit me të ardhura mujore deri në 1000 euro, me 20 euro.

OBLIGOHEN Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Pronë dhe Financa ta zbatojnë këtë vendim.

**II.**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së tij.

**ARSYETIM**

Për shkak të pamundësisë financiare të shumë prindërve për të përballuar koston e çerdheve me bazë në komunitet, Kryetari i Komunës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**I DORËZOHET:**

- Drejtorisë së Arsimit;
- Drejtorisë për Financa dhe Pronë; dhe
- Qendrës për shërbim me qytetarë.

**KRYETARI I KOMUNËS**

